

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE,
S.H.S REAL ESTATE sh.p.k

Sot me daten 18 Janar 2022, ne Durres , Shqiperi z. Sulejman Sino, shtetas shqiptar, lindur ne 5 maj 1967 ne Tirane , me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me karte identiteti Nr. G70505110U ka vendosur:

Themelimin e Shoqerise tregtare S.H.S Real Estate sh.p.k me termat e meposhtme:

Neni 1.

Forma

Shoqeria **S.H.S Real Estate sh.p.k** eshte formuar si shoqeri tregtare sipas ligjit 9901 date 14/4/2008" Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"(ne vijim Shoqeria)

Shoqeria eshte person juridik privat shqiptar.

Shoqeria ka seline e saj ne Durres, Shqiperi dhe mund te vendose ose heqe seli sekondare apo zyra perfaqesimi ne qytete te tjera brenda vendit ose jashte territorit shteteror te Shqiperise.

Neni 2.

Emri I Shoqerise

Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin juridiko-civil me emrin **S.H.S Real Estate sh.p.k**

Neni 3

Objekti I veprimtarise

Shoqeria ka per objekt, ne perputhje me kerkesat ligjore, veprimtarite e meposhtme:

Shitje, blerje, dhenie apo marrje me qera te pronave te paluajtshme , qofshin ato residenciale apo komerciale (shtepi, apartamente, vila, toke bujqesore, troje, dyqane, magazina, lokale)

Shoqeria ne objektin e saj perfshin : konsulence, marketim, gen-plane.

Neni 4

Selia e Shoqerise

Selia e Shoqerise **S.H.S Real Estate sh.p.k** ndodhet ne Durres ne adresen : Rr.Albania, L.17 Durres, Shqiperi

Neni 5

Kapitali I Shoqerise

Kapitali themeltar I Shoqerise do te jete I perbere nga kontributi I Ortakut te vetem (themelues) te saj, ne para, ne vleren 100.00 Euro.

Kapitali I Ortakut themelues eshte si me poshte:

Sulejman Sino 100.00 euro, - zoteron 100%.

Neni 6

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar, ne perputhje me Statutin e Shoqerise.

Afati I aktivitetit fillon pas rregjistrimit te Shoqerise ne rregjistrin tregtar.

Cdo aktivitet tregtar perfundon me daten 31 dhjetor te cdo viti.

Aktiviteti I pare tregtar perfundon me 31 dhjetor 2022.

Neni 7

Organet drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise, bazuar ne ligjin 9901 date 14/4/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" jane si me poshte:

1. Asambleja e pergjithshme e Ortakut te vetem
2. Administratoret

Organizimi dhe funksionimi I tyre eshte percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Shoqeria do te administrohet fillimisht nga Ortaku I vetem, ne rolin e Administratorit.

-Administratori zgjidhet nje here ne tre vjet ose ne rast se asambleja vendos nje gje te tille, kur vendi mbetet vacant per arsye shendetsore, revokim te postit, doreheqje, shkelje ligjore apo shkelje te Statutit te Shoqerise.

-Asambleja merr vendime me shumice votash te pranishme.

-Ne rast se Ortaku I vetem eshte I pranishem ne mbledhjen e Asamblese, ai konsiderohet nje vote.

-Nese Ortaku I vetem nuk eshte I pranishem ne mbledhjen e Asamblese dhe nuk eshte dakord me vendimin e saj, ai ka te drejte te vendose veton mbi vendimet e Asamblese.

-Administratori zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme. Ose ne pamundesi emerohet nga Ortaku I vetem, sipas Statutit te Shoqerise.

-Administrator I Shoqerise eshte z. Sulejman Sino, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 5 maj 1967, me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe I identifikuar me karten e identitetit Nr. G70505110U

-Shoqeria fillimisht eshte e administruar nga nje administrator I vetem, por ne te ardhmen mund te administrohet nga nje apo disa administratore, edhe nese jane jo ortake, ne perputhje te plote me aktin e emerimit.

Kur administrimi I besohet disa personave (administratore) ata duhet te veprojne ne menyre kolegjiale duke formuar keshillin e administrimit. Ne te kundert duhet percaktuar nese administrimi eshte caktuar bashkerisht ose jo.

Neni 8

Punesimi

Shoqeria ka te drejte te punesoje personelin e saj , bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe ne perputhje me Statutin.

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise, mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne Shoqerine per demin e shkaktuar gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

Neni 9

Organizimi

Organizimi dhe funksionimi I Shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj, do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit perkates dhe Statutit.

Neni 10.

Ligji I aplikueshem

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet nga Statuti, I firmosur nga Ortaku I vetem (themelues), sipas parashikimt te ligjit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 11

Zgjidhja e moosmarreveshjeve

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me themelimin e Shoqerise apo gjate aktivitetit te saj, do te zgjidhen nga Ortaku I vetem (themelues), ne te kundert do ti drejtohen gjykates se rrethit gjyqesor ku ndodhet selia e Shoqerise.

Neni 12

Dispozita perfundimtare

Akti I themelimit hartohet ne 4(kater) kopje dhe pasi u lexua nga Ortaku I vetem (themelues), u gjet ne perputhje me vullnetin e tij dhe u nenshkrua pa verejtje.

ORTAKU I VETEM (THEMELUES)

Z. SULEJMAN SINO

Firma

